



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 48, datë 28.03.2024

**PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT, KRYETARIT DHE
ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS SË SHOQËRISË
“ATLANTIK-SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 22, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Luan Bregasi si kryetar dhe z. Aleksandër Muskaj si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës së shoqërisë “Atlantik – Shoqëri Sigurimesh” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 2. Miratimin e riemërimit të z. Dritan Çelaj si administrator i shoqërisë “Atlantik – Shoqëri Sigurimesh” sh.a., për një periudhë 3 vjeçare.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**